



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
S-036
Prishtinë, më 16, 22 e 23 korrik 2015

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 16, 22 DHE 23 KORRIK 2015**

Seancën e drejtoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmuan: Sabri HAMITI dhe Slobodan PETROVIQ, nënkryetarë të Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare dhe procedoi me pikat e rendit të ditës, të caktuara nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, si në vijim:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Nezir Çoçaj, Teuta Haxhiu, Valdete Bajrami, Faton Topalli, Bekim Haxhiu, Time Kadrijaj, Besa Baftija, Haxhi Shala, Shukrije Bytyqi, Zafir Berisha, ministri Arsim Bajrami dhe ministri i Financave, Avdullah Hoti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Faton Topalli parashtrroi pyetje për kryeministrin Isa Mustafa në lidhje me opsionin e Qeverisë për Gjykatën Speciale pas refuzimit të Kuvendit që ta formojë në formën e propozuar nga Qeveria.

Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Ismajl Kurteshi, parashtroi pyetje për ministren, Hykmete Bajrami, në lidhje me evazionin fiskal, që paraqet një abuzim të rëndë, ndaj shkelësve të cilët importojnë naftë jo cilësore e cila sipas ekspertëve të pulmologjisë është shkaktare e sëmundjeve të rënda, duke rrezikuar seriozisht shëndetin publik e që përbën po ashtu një vepër të rëndë penale, a është proceduar në organet e Prokurorisë ndonjë rast i tillë?

Ministrja Hykmete Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetit Ismajl Kurteshi.

Deputetja Shukrije Bytyqi parashtroi pyetje për kryeministrin Isa Mustafa në lidhje me licencimin e mbi 100 studentëve të FSHMN-së, Departamenti i Biologjisë të studimeve themelore të regjistruar në vitin akademik 2005-2006 dhe 2006-2007, të cilët kanë mbetur pa të drejtë licencimi dhe punësimi.

Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Shqipe Pantina parashtroi pyetje për kryeministrin Isa Mustafa në lidhje me pozitat e identifikuar si deficitare në fondin për kuadro për të cilat bartësit e këtyre pozitave janë paguar me pagë shtesë dhe çfarë kualifikime profesionale kanë pasur bartësit e këtyre pozitave. Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Bekim Haxhiu nuk e lexoi pyetjen me shifrën DO-627, të parashtruar për ministrin Imet Rrahmani.

Ministri Imet Rrahmani ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Ismajl Kurteshi parashtroi pyetje për ministrin Arsim Bajrami në lidhje me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014 në UP dhe UPZ në lidhje me pagesën e profesorëve të cilët nuk kanë mbajtur rreth 1/3 e orëve për të cilën janë paguar dhe për nivelizimin e pagave të bordeve si dhe vlerën e teksteve shkollore të shpërndara në vitin 2014.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetit Ismajl Kurteshi.

Deputetja Labinotë Demi-Murtezi parashtroi pyetje për ministrin Arban Abrashi lidhur me afatet kohore për përfundimin e çështjes së licencimit të OJQ-ve.

Ministri Arban Abrashi iu përgjigj pyetjes së deputetes Labinotë Demi-Murtezi.

Deputeti Bekim Haxhiu parashtroi pyetje për kryeministrin Isa Mustafa në lidhje me mos funksionalizimin e Bordit të AKP-së, i cili nuk është funksional nga data 1 shtator 2014 dhe se me vendit të kujt është duke i shfrytëzuar ndërmarrja “TREPÇA” këta 3 muajt e fundit fondet e AKP-së nga xhirollogaria e veçantë.

Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Labinotë Demi-Murtezi parashtroi pyetje për ministrin Imet Rrahmani në lidhje me ngritjen e koeficientit të pagës për infermieret që kanë mbaruar Fakultetin e Infermierisë ose edhe gradën master, të cilave në disa qendra u kryhet kjo pagesë si p.sh, në Gjilan por jo edhe në qendrat të tjera.

Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetes Labinotë Demi-Murtezi.

Deputetja Albulena Haxhiu, parashtroi pyetje për kryeministrin Isa Mustafa në lidhje me mbrojtjen e ligjshmërisë sipas nenit 94 paragrafi 1 pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me përgjegjësinë për zbatimin e ligjit në lidhje me konfliktin e interesit në rastin e z. Besnik Berisha, këshilltar i kryeministrit për çështjet të drejtësisë.

Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Albulena Haxhiu parashtoi pyetje për ministrin Hajredin Kuçi në lidhje me mos procedimin e Projektligjit për kundërvajtjet.

Ministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Rexhep Selimi parashtoi pyetje për kryeministrin Isa Mustafa në lidhje me mos përgjigjen në pyetjet e parashtruara parlamentare nga ana e deputetëve.

Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Besa Baftija parashtoi pyetje për ministrin Imet Rrahmani në lidhje me përfshirjen në listë të pacientëve të cilët kanë indikacione mjekësore të sklerozës multiple, ku sipas të dhënave të një Komisioni neurologësh të Klinikës së Neurologjisë janë edhe 135 raste.

Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetes Besa Baftija.

Deputetja Aida Dërguti parashtoi pyetje për ministrin Lutfi Zharku në lidhje me zhvendosjen e Stacionit të autobusëve që është në shërbim të fshatrave, Lumë i Madh dhe Stanovc, nënkalimi i cili është bartur 100 metra nga udhëkryqi dhe pse janë duke u bllokuar punimet në unazën e urës në rrugën Prishtinë-Mitrovicë.

Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj pyetjes së deputetes Aida Dërguti.

* * *

Në vazhdim, për plotësimin e rendit të ditës u paraqitën deputetët: Nait Hasani dhe Naser Osmani.

Deputeti Nait Hasani, në emër të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, propozoi që në seancën e sotme të shqyrtohet pika - Ratifikimi i propozim-vendimit të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për themelimin e Universitetit Publik të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.

Për propozimet e lartpërmendura u deklaruan deputetët: Glauk Konjufca, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu, Ismet Beqiri, Adem Grabovci, Teuta Haxhiu dhe Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

* * *

Kryetari e hodhi në votim propozimin e parë të lartpërmendur të deputetit Nait Hasani.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 51,
Kundër ----- 10,
Abstenime ----- 11.

Kryetari, konstatoi se Kuvendi vendosi që në seancën e sotme të përfshihet edhe ratifikimi i propozim-vendimit të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për themelimin e Universitetit Publik të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.

Deputetja Albulena Haxhiu propozoi që të shtyhet për një seancë tjetër pika e 10 e rendit të ditës- debati parlamentar lidhur me veprimtarinë e misionit të BE-së në Republikën e Kosovës.

Kryetari hodhi në votim propozimin e dytë të lartpërmendur të deputetes Albulena Haxhiu.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 23,
Kundër ----- 58,
Abstenime ----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi propozimin e deputetes Albulena Haxhiu që të shtyhet për një seancë tjetër pika e 10 e rendit të ditës- debati parlamentar lidhur me veprimtarinë e misionit të BE-së në Republikën e Kosovës.

Deputeti Naser Osmani, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, propozoi që shqyrtimi i dytë i Projektligjit për faljen e borxheve publike, të bëhet me procedurë të përshpejtuar – shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, në lidhje me afatet procedurale të parapara me nenin 57, paragrafi 9 të Rregullores së Kuvendit.

Kryetari hodhi në votim propozimin e lartpërmendur të deputetit Naser Osmani.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 57,
Kundër ----- 11,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për faljen e borxheve publike, të bëhet me procedurë të përshpejtuar – shmangie nga rregullorja e Kuvendit.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. *Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
4. *Zgjedhja e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës,*
5. *Ratifikimi i propozim-vendimit të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për themelimin e Universitetit Publik të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj,*
6. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015,*
7. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurimet,*
8. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për faljen e borxheve publike,*
9. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar,*
10. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave,*
11. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale,*
12. *Kërkesa e deputetes Albulena Haxhiu, e mbështetur nga 5 deputetë nënshkrues, për debat parlamentar lidhur me veprimtarinë e misionit të BE-së në Republikën e Kosovës.*

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Kuvendi e miratoi pa vërejtje procesverbalin e seancës plenare, e mbajtur më 9-10 korrik 2015.

4. Zgjedhja e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës

Deputeti Ali Sadriu, në emër të Komisionit Funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike tha se ky komision ka shqyrtuar propozimin e presidentes së Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Auditorit të Përgjithshëm dhe Kuvendit i ka rekomanduar për shqyrtim në seancë plenare.

Fjala e z. Ali Sadriu është dhënë e plotë në transkript.

Kryetari, e hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Në vazhdim, në emër të GP të PDK-së diskutoi deputeti Naim Fetahu, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Më pas, kryetari sqaroi se bazuar në nenin 136, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës:

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës zgjidhet nga Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, në bazë të propozimit të Presidentit të Republikës së Kosovës, pra së paku 61, me mandat pesëvjeçar.

Kryetari, më tutje, hodhi në votim propozimin e presidentes së Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Auditorit të Përgjithshëm.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 36,
Kundër ----- 37
Abstenime -----10.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Kuvendi nuk e zgjodhi z. Valbon Bytyqi, Auditor të Përgjithshëm i Republikës së Kosovës.

5. Ratifikimi i propozim-vendimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për themelimin e Universitetit Publik të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj

Kryetari tha se Qeveria e Republikës së Kosovës ka proceduar në Kuvend, për ratifikim, propozim-vendimin për themelimin e Universitetit Publik të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.

Ai më tej tha se Komisioni Funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, e ka shqyrtuar propozimin e lartpërmendur dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Pastaj, kryetari e hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Arsim Bajrami, ministër i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, foli në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si propozues i çështjes, paraqiti dhe arsyetoi në Kuvend kërkesën për themelimin e Universitetit Publik të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.
Fjala e ministrit Arsim Bajrami është dhënë e plotë në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Nait Hasani, në emër të Komisionit Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport; Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Ismajl Kurteshi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”; Sasha Milosavljeviq, në emër të Grupit Parlamentar LS; Zafir Berisha, në emër të Grupit Parlamentar NISMA, si dhe zv/ kryeministri Hashim Thaçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Ratifikimit të Propozim-vendimit për themelimin e Universitetit Publik të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 68,
Kundër ----- 1,
Abstenime -----5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Ratifikohet vendimi i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për themelimin e Universitetit Publik të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, si institucion publik i arsimit të lartë.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funkcional Raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Raportin e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa e paraqiti deputeti Naser Osmani.

Kryesuesi Sabri Hamiti i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 19.

Kuvendi nuk i miratoi këto amendamente: 12, 14, 15, 16, 17 dhe 18.

Për amendamentin nr. 10 diskutuan deputetët: Fikrim Damka, Nait Hasani, Ismet Beqiri, Naser Osmani, Veton Berisha, ministri Avdullah Hoti, Rexhep Selimi, Shpejtim Bulliqi, Danush Ademi dhe Kujtim Paçaku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Për amendamentin nr. 11 diskutuan deputetët: Shpejtim Bulliqi, Naser Osmani, Armend Zemaj dhe Synavere Rysha, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Për amendamentin nr. 12 diskutuan deputetët: Teuta Haxhiu, Naser Osmani dhe Besa Gaxherri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Deputetja Duda Balje, e tërhoqi nga procedura amendamentin nr. 13.

Për amendamentin nr. 14 diskutuan deputetët: Faton Topalli, Naser Osmani, Blerim Grainca, Ganimete Musliu dhe Adem Grabovci, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Për amendamentet me nr. 15, 16 dhe 17 diskutuan deputetët: Enver Hoti dhe Salih Morina, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Për amendamentin nr. 18 diskutuan deputetët: Jasmina Zhivković, Naser Osmani, Nait Hasani, ministri Avdullah Hoti dhe Slavko Simiq, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Për amendamentin nr. 19 diskutuan deputetët: Qerim Bajrami, Emilija Rexhepi, Armend Zemaj, Nait Hasani, Shpejtim Bulliqi, ministri Avdullah Hoti dhe Duda Balje, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas, ministri Avdullah Hoti, propozoi që në lidhje me amendamentin 18 të bëhet ndryshim i ndarjeve buxhetore.

Fjala e ministrit Avdullah Hoti është dhënë e plotë në transkript.

Kryesuesi Sabri Hamiti, lidhur me propozimin e ministrit Avdullah Hoti, kërkoi deklarin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Për propozimin e ministrit Avdullah Hoti, u deklaruan deputetët: Naser Osmani, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa; Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Jelena Bontiq, në emër të Grupit Parlamentar LS; Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e ministrit Avdullah Hoti, në lidhje me ndarjet e reja buxhetore.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi me shumicë votash propozimin e ministrit Avdullah Hoti, në lidhje me ndarjet e reja buxhetore.

Më tej, kryesuesi e hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 63,
Kundër ----- 4,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin nr.05/L-046 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurimet

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për sigurimet.

Ministri Avdullah Hoti tha se qëllimi i këtij projektligji është trajtimi i çështjes së personave juridik dhe fizik që ushtrojnë veprimtari të sigurimeve dhe të risigurimeve, të ndërmjetësimit në sigurime si dhe subjekteve tjera që ushtrojnë aktivitete që lidhen drejtpërdrejt me veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve në vend.

Në vazhdim, ministri theksoi se kjo fushë aktualisht është e mbuluar përmes Rregullores së UNMIK-ut dhe si rezultat i kësaj është paraqitur nevoja e hartimit të këtij projektligji.

Në vazhdim ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z. Avdullah Hoti, është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Naser Osmani - në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Salihe Mustafa - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari në mungesë të kuorumit nuk hodhi në votim miratimin e Projektligjit për sigurimet.

Ai tha se për votimin e pikës së lartpërmendur si dhe shqyrtimin e pikave tjera sipas rendit të ditës do të vendoset në mbledhjen e radhës së Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari mbylli punimet e seancës së sotme, në orën 16:50 minuta.

* * *

22 korrik 2015, ora 14:00

Vazhdimi i mbledhjes plenare

Seancën e drejtoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Xhavit HALITI, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari, në fillim të seancës, u dëshiroi mirëseardhje bashkatdhetarëve në hapësirat e Kuvendit, një numër i të cilëve ishin të pranishëm në hapësirën e rezervuar për ta.

Më pas, deputeti Kujtim Paçaku, shprehu pakënaqësi me rastin e ndarjeve buxhetore për komunitetin Rom, të përcaktuara në Ligjin për rishikimin e buxhetit për vitin 2015.

Fjala e deputetit Kujtim Paçaku është dhënë e plotë në transkript.

Kryetari më pas procedoi me pikat si në vijim:

7. Votimi i Projektligjit për sigurimet

Kryetari tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në seancën e filluar më 16 korrik 2015, ndërsa procedimi me votim do të bëhet në seancën e sotme.

Kryetari e hodhi në votim Projektligjin për sigurimet.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 72,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi Projektligjin Nr. 05/L-045 për sigurimet.

Kuvendi ngarkoi Komisionin funksional për Buxhet dhe Financa si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e Projektligjit për sigurimet dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për faljen e borxheve publike

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funksional Raportues për Projektligjin për faljen e borxheve publike.

Kryetari hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4 dhe 5.

Më tej, kryetari hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 82,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funksional Raportues për Projektligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Kryetari hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 54, 55, 56, 57, 58, 60, 61A, 62, 63 dhe 64.

Kuvendi nuk miratoi këto amendamente: 31, 53 dhe 59.

Më tej, kryetari hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 70,
Kundër ----- 11,
Abstenime ----- 10.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin nr. 05/L-037 për tatimin mbi vlerën e shtuar.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave.

Kryetari hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Në lidhje me amendamentet me numrat: 27, 42 dhe 44, kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani dha sqarime shtesë në tekstin e këtyre amendamenteve.

Kuvendi amendamentet e lartpërmendura i miratoi sipas sqarimeve të deputetit Naser Osmani.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani, tërhoqi amendamentin numër 43.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42 dhe 44.

Më tej, kryetari hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 75,
Kundër ----- 16,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin nr. 05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për tatimin në të ardhurat personale.

Kryetari hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Në lidhje me amendamentet me numrat: 42, 66 dhe 68, kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani, dha sqarime shtesë në tekstin e këtyre amendamenteve.

Kuvendi i miratoi amendamentet e lartpërmendura sipas sqarimeve të deputetit Naser Osmani.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani, tërhoqi amendamentin numër 67.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66 dhe 68.

Më tej, kryetari hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 69,
Kundër ----- 13,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin nr. 05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale.

12. Kërkesa e deputetes Albulena Haxhiu, e mbështetur nga 5 deputetë nënshkrues për debat parlamentar lidhur me veprimtarinë e misionit të BE-së në Republikën e Kosovës

Kryetari e njoftoi Kuvendin se deputetja Albulena Haxhiu dhe 5 deputetë tjerë nënshkrues nga GP i Lëvizjes “Vetëvendosje”, në bazë të nenit 15.8 të Rregullores së Kuvendit, kanë kërkuar mbajtjen e një debati parlamentar lidhur me veprimtarinë e misionit të BE-së, në Republikën e Kosovës dhe skandalet e publikuara në mediumet publike vendore.

Ai ftoi deputeten Albulena Haxhiu, në cilësinë e propozueses të çështjes, që ta paraqesë dhe arsyetojë në Kuvend kërkesën për debat parlamentar.

Albulena Haxhiu tha se para shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, me ftesën e institucioneve të atëhershme të Kosovës, të ashtuquajtura “institucione të përkohshme vetëqeverisëse” dhe me miratimin e Këshillit Evropian të BE-së, është themeluar misioni i përkufizuar si veprim i përbashkët i Bashkimit Evropian. Sipas preambulës së këtij akti të miratuar nga Këshilli Evropian, ky mision i BE-së funksionoi në bazë të kornizës juridike të Rezolutës 1244, të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, që nga themelimi i tij e deri në ditët e sotme ky mision nuk ka funksionuar mbi bazën e një kornize juridike përmes së cilës do ta njihte shtetin e Kosovës, përkatësisht statusin e saj si Republikë sovranë.

Misioni i BE-së formalisht mbi bazën e aktit 2008 124 SFSF instaloi administratën dhe stafin i cili kishte kompetenca ekzekutive në tri komponentët më të rëndësishëm në Republikën e Kosovës. Pra, në komponentin e gjyqësisë, policisë dhe doganave. Madje, ky mision është cilësuar si misioni më i madh civil i themeluar në kuadër të politikave të përbashkëta për siguri dhe mbrojtje të Bashkimit Evropian.

Për ushtrimin e kompetencave ekzekutive nga ana e këtij misioni, Kuvendi i Republikës së Kosovës kishte miratuar Ligjin mbi kompetencat për zgjidhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, mbi bazën e të cilit gjyqtarët dhe prokurorët i zhvillonin proceset gjyqësore në mënyrë të pavarur nga organet vendore të gjyqësisë në Republikën e Kosovës. Për më tepër janë edhe 7 ligje tjera mbi bazën e së cilës ky mision ka ushtruar kompetencat ekzekutive në të tri komponentët e përmendura në pikën 2 të kësaj kërkesë.

Pra, në bazë të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në bazë të Kodit të Procedurës Penale, Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Ligjit për Departamentin e Mjekësisë Ligjore, Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve, Kodin doganor dhe akcizave të Kosovës dhe Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, ndonëse Republika e Kosovës nëpërmjet organeve të saj të pushtetit legjislativ i krijoi një bazë ligjore për ushtrimin e kompetencave më vitale të natyrës ekzekutive, ky mision nuk e njohu dhe ende nuk e njeh shtetësinë e Republikës së Kosovës.

Tani pas 7 vjetëve veprimtarie në Kosovë të misionit ndërkombëtar të BE-së, në opinion janë duke u publikuar skandalet e njëpasnjëshme korruptive. Krahas dështimit të misionit të BE-së në dhënien e ndihmës të institucioneve vendore dhe jetësimin si mision i zbatimit të Ligjit përmes kompetencave ekzekutive po vërtetohet edhe nga vetë raportet e brendshme të BE-së, çfarë kemi deklaruar ne si subjekt politik prej vitesh se vetë ky mision është një nga gjeneratorët dhe ndër shkaktarët kryesor të mbështetjes dhe mbrojtjes së krimit të organizuar dhe korrupsionit krahë për krahë me drejtuesit kryesorë të qeverive pas shpalljes së pavarësisë.

Vetëm para disa muajve, prokurorja e EULEX-it z. Maria Bamie, u deklarua publikisht për akuzat që përfshin veprimtarinë mitëmarrje dhe korrupsioni nga prokurorë dhe gjyqtarë të EULEX-it, të cilët kishin marrë pjesë në gjykimin e një serie rastesh të rëndësishme. Nga publikimi i këtyre skandaleve del se prokurorë dhe gjyqtarë kanë marrë të holla në sasi të konsiderueshme nga personat që procedoheshin në çështje penale të trajtuara nga stafi i EULEX-it. Po ashtu, qytetarët në Kosovë gjatë gjithë kësaj kohe kanë kuptuar që në udhëheqjen e këtij misioni janë montuar disa procese gjyqësore në ndikimin politik ku ishin të inkriminuar zyrtarët më të lartë të EULEX-it dhe zyrtarët e Qeverisë së Kosovës, si ajo me aferën korruptive në Ministrinë e Transportit, gjykimi për rastin ” Kleçka,” ishin disa nga proceset më të mëdha që në prapavijë kishin qëllime politike.

Në muajin prill të këtij viti, në lagjen Suhadoll të Mitrovicës, ndodhi një rast tragjik, në të cilën u raportua se një djalë i mitur ishte zhdukur dhe dyshimet në opinion ishin hedhur se i njëjti ishte mbytur në lumin Ibër. Vetëm pas disa ditëve të kërkimit të trupit të tij, ai ishte gjetur, por për shkaqe të vdekjes nuk u tha asgjë publikisht nga organet. Deri më tani nga pak informacione që i kemi, të inkriminuar janë dy persona të nacionalitetit serb, banorë të pjesës veriore të lumit Ibër dhe të njëjtëve iu është konfiskuar arma e zjarrit për të cilën dyshohet se është përdorur gjatë përndjekjes ndaj të miturit, trupi i të cilit u gjend në këtë lumë.

Më pas, deputetja Albulena Haxhiu, paraqiti para deputetëve të Kuvendit propozim-rezolutën lidhur me veprimtarinë e misionit të BE-së, në Republikën e Kosovës dhe skandalet e publikuara në mediumet publike vendore dhe ftoi deputetët që ta miratojnë Propozim-rezolutën.

Fjala e deputetes Albulena Haxhiu është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi i seancës e hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetvendosje”; Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Valdete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”, si dhe Ilir Deda, Nait Hasani, Kujtim Paçaku, Visar Ymeri, Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyqi, Nuredin Ibishi, Ismajl Kurteshi, Rexhep Selimi, Zafir Berisha, Albin Kurti, Emilija Rexhepi, Puhie Demaku, Mytaher Haskuka, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në fund, kryesuesi, për mungesë të kuorumit nuk e hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës dhe i mbylli punimet e seancës së sotme në orën 17:10 minuta.

23 korrik 2015

Vazhdimi i mbledhjes plenare

Seancën e drejtoi Xhavit HALITI, nënkryetar i Kuvendit.

Nënkryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të seancës plenare të filluar më 16 dhe 22 korrik 2015.

Ai tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në seancën të datës 22 korrik 2015, mirëpo në mungesë të kuorumit procedimi me votim bëhet në seancën e sotme.

Kryesuesi hodhi në votim propozim-rezolutën lidhur me veprimtarinë e misionit të BE-së në Republikën e Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 23,
Kundër----- 17,
Abstenime----- 23.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Republikës së Kosovës, miratoi këtë

R E Z O L U T Ë

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës e fton presidenten e Republikës, znj. Atifete Jahjaga, që t'i kërkojë Komisionares së Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri të BE-së, znj. Frederica Mogherini, inicimin e hetimit institucional për çdo rast të cituar për stafin e EULEX-it në raportin që zyrtarët e BE-së e kanë hartuar.

2. Të thërrasë në raportim të jashtëzakonshëm kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me aferat që kanë të bëjnë me ndikimin e çështjeve hetimore të zyrtarëve të EULEX-it dhe marrjes arbitrare të kompetencave të organeve të drejtësisë nga EULEX-i.

3. Raportimi i kryesuesve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës të bëhet dhjetë (10) ditë nga miratimi i kësaj rezolute.

4. Kjo rezolutë hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare në orën 10:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Kadri VESELI

E përgatiti:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale